



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 140 prot.

Kamëz, më 08.11.2021

V E N D I M

Nr. 112 Datë 19/11/2021  
MBI

MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË JANË REKOMANDUAR NGA  
ADMINISTRATORËT SHOQËRORË PËR TRAJTIM ME FONDIN 6% TË BLOK-  
NDIHMËS EKONOMIKE

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 19.11.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendim Nr.102 Datë 16.11.2021** mbështetur në Ligjin 57, datë 18.07.2019 “Mbi Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, VKM nr. 956, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimet shoqërore”; Kreun IV, pika 2, të Vendimit nr. 955 datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” të ndryshuar; Udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%”, të ndryshuar; Kreun IV, pika 3, të VKM nr. 597 datë 04.09.2019, “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”. dhe në VKB nr 158 datë 18.12.2020, “Mbi miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së **muajit TETOR 2021, prej 44familjeve me një fond prej 146,072 (njëqind e dyzetë e gjatëmijë e shtatëdhjetë e dy) lekë**, të cilët janë rekomanduar nga administratorët shoqërorë, për përfitim nga fondi 6% i bllok-ndihmës ekonomike.
2. Lista e familjeve të cituara në pikën 1 të këtij projekt-vendimi, paraqitet në relacionin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Kryetar Këshilli  
**Hysen Koldashi**

